



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**LOCAL GOVERNANCE  
PROGRAM IN ALBANIA**

## HISTORI SUKSESI

### Vëzhgimi i Nevojave të Biznesit në Fushë-Krujë, një hap pozitiv drejt përmirësimit të komunikimit midis bizneseve dhe pushtetit vendor



*Znj. Arjola Bushi, përfaqësuese e firmës "BABASICOO", duke shprehur opinionet e saj në lidhje me ekonominë e Fushë-Krujës, ndihmuar nga anëtari i Komitetit për Zhvillimin e Ekonomisë Vendore, z. Bardhyl Sala.*

**Rezultatet e vëzhgimit tregojnë se Fushë-Krujë konsiderohet si një vend i mirë për të bërë biznes: vendodhja, bollëku i burimeve natyrore, (përfshirë gëlqeren dhe materiale balte), si dhe disponueshmëria e fuqisë së kualifikuar punëtore janë disa nga faktorët kryesorë. Pjesa më e madhe e bizneseve (64%) kanë në plan të zgjerojnë veprimtarinë e tyre në të ardhmen. Bizneset besojnë se agro-biznesi, agropërpunimi, industria e rëndë dhe përpunimi i drurit janë sektorët vendor që po rriten vazhdimisht.**

Komiteti i Zhvillimit të Ekonomisë Vendore të Fushë-Krujës, i ngritur me ndihmën e Programit të Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA), përbëhet nga 20 anëtarë, përfshirë këtu personelin e bashkisë dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile. Në shkurt të vitit 2008, Komiteti bëri një vlerësim të avantazheve dhe dobësive të zhvillimit vendor, evidentoi mundësitë për rritjen ekonomike, si dhe përcaktoi politikatat që duhet të zbatohen me qëllim nxitjen e rritjeve vendore dhe për të inkurajuar një 'mjedis miqësor për biznesin'.

U hartua një plan veprimi për të drejtuar ndërhyrjet e Programit të Qeverisjes Vendore në mbështetje të objektivave të bashkisë së Fushë-Krujës për zhvillimin e qytetit. Brenda këtij kuadri, dëshira për të përfshirë sektorin privat në përmirësimin e klimës vendore të biznesit u realizua nëpërmjet një sondazhi për nevojat e biznesit.

Me mbështetjen e Programit LGPA, përfaqësues nga Komiteti i Zhvillimit të Ekonomisë vendore, të drejtuar nga anëtari i këtij komiteti, z. Bardhyl Sala, zgjodhën 28 biznese që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në Fushë-Krujë për të marrë pjesë në sondazh, duke përfaqësuar kështu një gamë të gjerë të bizneseve përsa i përket madhësisë dhe veprimtarisë së bizneseve. Të intervistuarit në këtë vëzhgim shprehën shqetësimet e tyre si dhe sugjeruan mënyra për të përmirësuar klimën e biznesit në Fushë-Krujë.

Sugjerime konkrete për përmirësim përfshinin: zgjerimin e infrastrukturës, krijimin e një sistemi parkimi për qytetin, pastrimin më të mirë të qytetit, si dhe inkurajimin e një bashkërendimi dhe bashkëpunimi më të mirë mes bizneseve. Personeli i bashkisë duhet të tregojë edhe më shumë ndërgjegjësim për shqetësimet e biznesit si dhe të njihet më mirë me problemet e tyre; të kufizojnë tregun/ tregtinë informale në qytet, si dhe të përgatisin një plan mbarë-qytetës si bazë për marrjen e vendimeve për dhënien e lejeve për hapjen e bizneseve të reja.

*Siç u theksua edhe nga z. Bardhyl Sala, "Rezultatet e vëzhgimit do t'i mundësojnë bashkisë, Komitetit të Rritjes së Ekonomisë Vendore si dhe Programit LGPA të kuptojnë më mirë perceptimin e bizneseve vendase për ekonominë e qytetit dhe mënyrat e ndryshme për ta përmirësuar atë. Me anë të këtij vëzhgimi, bashka dhe Komiteti kanë tashmë informacionin e duhur për klimën vendore për biznesin si dhe planet dhe shpresat e komunitetit të biznesit. Kjo ishte pikërisht ajo që donim. Tashmë ndryshimet pozitive në qytet kanë filluar."*